

Primi i sigurimit Mtpl kategoria - Autoveturë dhe faktorëve të riskut

që aplikohen nga 1 JANAR 2025

- Shoqëria e sigurimit Albsig sh.a. në zbatim të Rregullores nr. 156, datë 19.09.2024 “Për përcaktimin e faktorëve të riskut që përfshihen në përllogaritjen e primit për produktet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, ka aplikuar faktorët e riskut në përllogaritjen e primit të sigurimit për kategorinë e autoveturave të produktit të sigurimit të detyrueshëm motorik, MTPL e brendshme.
- Primi i sigurimit përllogaritet në nivel kategorie B1-Autoveturë si më poshtë:

$$P_{S,K} = \frac{PR,K}{(1-(\alpha+\beta+\gamma))}$$

- Në vijim në bazë të rregullores aplikohen dhe faktorët e tjerë të riskut si më poshtë:
- $P_{S,FR} = P_{S,K} \cdot h_D \cdot g_j \cdot m_i \cdot n_e \cdot P_{S,i} \cdot Q_p \cdot V_m \cdot F_{tj}$

ku - $P_{S,FR}$ përfaqëson primin e sigurimit bazuar në faktorët e riskut;

Shoqëria Albsig përcakton faktorët e riskut si më poshtë:

- **h_D** përfaqëson faktorin e riskut - Historiku i dëmeve për të siguruarin, përfshirë edhe rastet kur shkaktari i aksidentit nuk është i shënuar në policën e sigurimit - **Ky faktor rrisht për vitin 2025 do të jetë 1, pasi viti 2025 konsiderohet viti 0.**
- **g_j** përfaqëson faktorin e riskut fuqia motorike dhe indeksi j ndahet në shtatë klasa.

Klasat e faktorit paraqiten si më poshtë:

| Klasa | Vlerat e koeficientëve |
|---|------------------------|
| I. Deri në 1300 cm ³ | 0.907 |
| II. Nga 1301 deri në 1600 cm ³ | 0.95 |
| III. Nga 1601 deri në 1800 cm ³ | 0.996 |
| IV. Nga 1801 cm ³ deri në 2000 cm ³ | 1.05 |
| V. Nga 2001 cm ³ deri në 2500 cm ³ | 1.1 |
| VI. Nga 2501 cm ³ deri në 3000 cm ³ | 1.15 |
| VII. Mbi 3000 cm ³ | 1.196 |

- Automjetet elektrike shoqëria Albsig sh.a. do t'i klasifikojë deri në 1300 cm³.

- **mi** përfaqëson faktorin e riskut moshë e të siguarit. Indeksi *i* ndahet në dy klasa ku shoqëria Albsig ka konsideruar koeficientët më poshtë:

| Klasa | Vlerat e koeficientëve |
|-----------------------|------------------------|
| I. 18 deri në 21 vjeç | 1.15 |
| II. Të tjerë | 1 |

- **ne** përfaqëson faktorin e riskut eksperiencë në drejtim të mjetit motorik. Për të siguarit të ndryshëm nga 18 deri në 21 vjeç, indeksi ndahet në dy klasa, ku shoqëria Albsig ka mbajtur vlerën minimale të rregullores si vijon:

| Klasa | Vlerat e koeficientëve |
|--------------------|------------------------|
| I. Deri në dy vite | 1 |
| II. Mbi dy vite | 1 |

- **Ps,i** përfaqëson faktorin e riskut Përdorimi i mjetit: subjekt, individ. Indeksi ndahet në dy klasa, ku shoqëria Albsig ka konsideruar koeficientët më poshtë:

| Klasa | Vlerat e koeficientëve |
|-------------|------------------------|
| I. Individ | 1 |
| II. Subjekt | 1.2 |

Për subjektet bazuar në rregullore do të zbatohen faktorët: përdorimi i mjetit, fuqia motorike, qarku i regjistrimit të mjetit, si dhe vjetërsia e mjetit, por nuk do të zbatohet faktori moshë.

- **Qp**, përfaqëson faktorin e riskut Qarku i regjistrimit të mjetit. Indeksi ndahet në dy klasa, ku shoqëria Albsig ka konsideruar koeficientët më poshtë:

| Klasa | Vlerat e koeficientëve |
|------------------------|------------------------|
| I. Berat, Dibër, Kukës | 0.97 |
| II. Të tjera | 1 |

- **Vm**, përfaqëson faktorin e riskut Vjetërsia e mjetit. Indeksi ndahet në katër klasa ku shoqëria Albsig ka konsideruar koeficientët më poshtë:

| Klasa | Vlerat e koeficientëve |
|-----------------------------|------------------------|
| I. Deri në 5 vjet | 0.98 |
| II. Nga 6 deri në 10 vjet | 0.997 |
| III. Nga 11 deri në 15 vjet | 1.02 |
| IV. Mbi 15 vjet | 1.05 |